VENDIM
Nr. 325, datë 28.5.2014

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 149, DATË 29.2.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 149, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1 të vendimit, pas emërtesës "Drejtues institucioni" shtohet "zëvendësdrejtues". Kategoria e pagës për këtë funksion është II-b, ndërsa elementet e tjera përbërëse të pagës janë të njëjta me ato të funksionit "drejtues institucioni".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama